

SKËNDER ZHITIA**USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS
1994-1999****Zanafilla e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

Ngjarja më e rëndësishme për shqiptarët e Kosovës në shek. XX dhe, në përgjithësi për shqiptarët, pa dyshim ka qenë lufta çlirimtare gjatë viteve 1998-1999 e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK).

UÇK, e cila për herë të parë në histori i kishte tejkaluar kufijtë rajonalë të territorit të brendshëm të Kosovës, ka një zanafillë në përpjekjet e vazhdueshme të popullit shqiptar për liri, e cila ndërlidhet me gjendjen e përgjithshme shoqërore, ekonomike, politike e, mbi të gjitha, me ngritjen e vetëdijes kombëtare. Kjo zanafillë është domethënëse dhe me rëndësi të veçantë.

Populli shqiptar i Kosovës, kundër mbetjes së padrejtë nën pushtetin e të huajve, i paraqiti pakënaqësitë në forma të ndryshme nga viti 1913 e deri në vitin 1939. Manifestimi i revoltës vijoi edhe pas Luftës së Dytë Botërore e deri në vitin 1981. Janë të njohura për opinionin shqiptar shprehja e pakënaqësive përmes lëvizjeve ilegale të viteve 1968, 1974/75 etj. Viti 1981 sjell një ndërrim në formën e paraqitjes së pakënaqësive të akumuluar të popullit shqiptar ndër vite. Shpërthimi i revoltës së popullit shqiptar në demonstrata u ndikua nga shumë faktorë dhe gjendja e krijuar ndër vite ishte bërë e padurueshme.¹

Nga viti 1981 deri në vitin 1994 (viti i themelimit të UÇK-së) ndodhën disa ngjarje të lidhura midis tyre dhe të pandashme në aspektin kronologjik. Burgosjet e shumta, izolimet, likuidimet, vrasjet etj., të cilat kishin për qëllim thyerjen dhe shuarjen e vullnetit dhe të bindjes së shqiptarëve për liri. Në mesin e këtyre ngjarjeve, spikasin vitet 1981-1984, ku është i njohur eliminimi i Jusuf e Bardhosh Gërvallës, Kadri Zekës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës dhe Bajram Bahtirit nga organet e zbulimit jugosllav. Flijimi i tyre mund të konsiderohet edhe si një

¹ Sabit Sylja, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës (1939-1981)*, Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, Prishtinë: 2013, f. 319.

zanafillë e krijimit të bindjes se zgjedha serbe nuk mund të flakej tutje përveçse përmes luftës së armatosur. Prandaj, këtu mund ta gjejmë zanafillën e idesë për krijimin e një force ushtarake. Pas këtyre ngjarjeve, në kuadër të zanafillës së UÇK-së, një vend me rëndësi ka viti 1985, në të cilin u mor vendimi i lëvizjes për Republikën e Kosovës për formimin e krahut ushtarak.

Gjatë kësaj kohe në Kosovë vepronte Komiteti Organizativ, si organ politik i Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). Në fillim të vitit 1985 u vendos që të formohej Byroja Ekzekutive, e cila mendohej që të luante rolin e qeverisë apo organit ekzekutiv, me të gjitha segmentet dhe funksionet e një qeverie në ilegalitet. Ajo udhëhiqej nga Hilmi Reçica, Xhabir Morina, Bashkim Mazreku, Xhavit Haliti, Fehmi Lladrovci, më vonë Xhavit Haziri (edhe sot trajtohet i zhdukur, është arrestuar në vitin 1998), Nuhi Ahmeti, Avdullah Dërguti, Sadik Halitjaha, Hajdin Abazi etj. Byroja Ekzekutive mori edhe vendimin për formimin e njësisve guerile.²

Gjatë viteve 1987-‘89, pas lirimit nga burgjet jugosllave të një numri të konsideruar veprimtarësh të dëshmuar për sakrificë e atdhedashuri, filloi riorganizimi i lëvizjes ilegale në luftë kundër shtypjes së pushtetit jugosllav.³ Gjatë kësaj periudhe, me ndryshime të vogla, LPRK brenda vendit drejtohej kryesisht nga: Fadil Vata, Sabri Kiçmari, Beqir Beqa, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Bardhyl Mahmuti, Binak Berisha, Bajram Kadriu, Xhabir Morina, Ahmet Haxhiu, Sahit Krasniqi, Shaban Muja, Azem Syla, Xhavit Haziri, Ibish Neziri, Musa Demiri, Ramadan Avdiu, Ilaz Kadolli, Behajdin Hallaçi e shumë të tjerë.⁴ Pas riorganizimeve të LPRK-së, në fund të viteve 80-të shtohen veprimet e organizuara guerile. Në vitet 1988/89 fillojnë aksione të armatosura, të cilat vazhdojnë edhe në vitet në vijim.⁵ Këto aksione shihen gjatë demonstratave të vitit 1989, si: organizimi i çetës së Llapit, lufta e saj dhe rënia e Ali Ajetit,⁶ beteja në

² Xhavit Haliti, “Si e bëmë UÇK-në”, në *Zëri*, Prishtinë, shkurt 2001-janar 2003. Intervista është botuar në *Libri i Lirisë*, Prishtinë: Zëri, 2003, f. 18.

³ Ramadan Avdiu, Sabri Kiçmari, intervista dhënë autorit.

⁴ Xh. Haliti, “Si e bëmë UÇK-në ...”, f. 19.

⁵ Po aty.

⁶ Sipas Sabri Kiçmarit, ky organizim ushtarak u quajt kështu nga populli. Fjalim i mbajtur në akademinë përkujtimore kushtuar Hasan Ramadanit, Prishtinë, 7 gusht 2007.

Kodër të Diellit në Prishtinë më 2 nëntor 1989 ku ranë Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu.⁷

Organizimi dhe realizimi i ushtrimeve ushtarake në Shqipëri në vitin 1991, rezistenca e armatosur e Adem Jasharit me bashkëluftëtarë, më 30 dhjetor 1991 (grupi i Drenicës nën udhëheqjen e Adem Jasharit, më vonë pas formimit të UÇK-së, ishte ndër bërthamat më të organizuara të UÇK-së), organizimi i njërive guerile në vende të ndryshme të territorit të Kosovës, shpërndarja e armatimit në vitet 1991/1992 etj., duke mos mohuar edhe ngjarje të tjera gjatë këtyre viteve dhe më herët, ishin ngjarje që mund të cilësohen si zanafilla ose parahistoria e UÇK-së.⁸

Një hap tjetër përpara u bë kur Lëvizja për Republikën e Kosovës, dega jashtë vendit, në një nga mbledhjet e mbajtura në Zvicër në mars të vitit 1993, kishte konstatuar se, për të dalë nga kriza, e cila ishte krijuar pas burgosjeve dhe largimit të shumë aktivistëve të saj nga Kosova në vitet 1992/1993, duhej ndërruar strategjia e veprimit dhe, përveç të tjerash, duhej krijuar një mekanizëm i veçantë ushtarak.⁹ Në vazhdim, në prill 1993, në Kollare të Kërçovës, u mbajt mbledhja konsultative e LPRK-së, ku merrnin pjesë: Gafurr Elshani, Ahmet Haxhiu, Ali Ahmeti, Adnan Asllani, Hashim Thaçi, Azem Syla, Behajdin Hallaçi, Adem Grabovci, Halil Selimi, Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Hidajete Krasniqi, Binak Berisha, Hysen Gega, Ramadan Pllana, Ilaz Kadolli, Fadil Bajrami, Musa Demiri, Behxhet Luzha, Fatmir Brajshori etj.¹⁰ Në këtë takim u arrit në përfundimin se LPRK duhej të mbështeste të gjitha aksionet e armatosura kundër pushtuesve. Gjithashtu, u krijua Grupi i Organizimit dhe Riorganizimit (GOR), i cili u ngarkua me detyrë për të organizuar mbledhjen IV të Përgjithshme të LPRK. Grupin e përbënin: Ramadan Avdiu, kryetar i grupit, anëtar Hashim Thaçi, Adnan Asllani, Bilall Sherifi dhe një person nga Maqedonia.¹¹

⁷ Fazli Veliu, “Motivimi kulminant për ne dhe popullin tonë është krijimi i UÇK-së”, në *Bota e re*, korrik, 1997.

⁸ Hashim Thaçi, program dokumentar i RTK-së kushtuar dëshmorit Afrim Zhitia, viti 2002.

⁹ Xh. Haliti, “Si e bëmë UÇK-në ...”, f. 32.

¹⁰ Burim Etemaj, “Flet Ramadan Avdiu, veprimtar i hershëm i çështjes kombëtare”, në *Epoka e re*, Prishtinë: 24.04.2004; Emrush Xhemaili, *20 vjet veprimtari*, Prishtinë: 2002, faqja e internetit: www.lpk-kosova.com (data e leximit 18.06.2006).

¹¹ B. Etemaj, “Flet Ramadan Avdiu, veprimtar i hershëm i çështjes kombëtare ...”; Ramadan Avdiu, intervistë dhënë autorit, viti 2008; E. Xhemaili, *20 vjet veprimtari ...*, (faqja e internetit: www.lpk-losova.com)

Grupi i Organizimit të Mbledhjes IV të Përgjithshme të LPRK-së, pas përgatitjeve të duhura, më 26-27 korrik 1993, në Kodër të Trimave në Prishtinë, në shtëpinë e Fatmir Brajshorit, organizoi Mbledhjen IV të Përgjithshme të LPRK-së.¹² Në këtë mbledhje morën pjesë Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Bilall Sherifi, Mehmet Bislimi, Halil Selimi, Adnan Asllani, Xhemail Rudi, Guximtar Labenishti, Ejup Thaçi, Mustafë Krasniqi, Isa Krasniqi, Xheladin Gashi, Fatmir Brajshori, si dhe delegatët nga Dega Jashtë Vendi: Fazli Veliu, Emrush Xhemajli, Beqir Beqa, Sabri Këçmari, Bilall Sherifi e të tjerë drejtues dhe delegatë nga terreni. Mbledhjen e ka udhëhequr kryesia e punës e përbërë nga Fazli Veliu, Xhavit Haziri dhe Adnan Asllani. Atë e shpalli të hapur delegati më i vjetër Fazli Veliu, ndërsa procesverbalin e mbajti Emrush Xhemajli.¹³ Në mbledhje u bënë ndryshime programore e statutore dhe u ndërrua emri nga LPRK në Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK). Në program tekstualisht u aprovua si mjet i arritjes së qëllimit për çlirimin e Kosovës dhe viseve shqiptare në ish-Jugosllavi lufta e armatosur. Në këtë takim u aprovua rezoluta, e cila përcaktonte se lufta e armatosur duhej të ishte prioritet i veprimeve të LPRK-së dhe u formua krahu ushtarak.¹⁴ Në krahun ushtarak u caktuan Azem Syla e Xhavit Haziri në Kosovë, ndërsa Xhavit Haliti u autorizua që të merrej me organizimin ushtarak në Shqipëri dhe në diasporë. Për të jetësuar këto vendime u organizuan takime me drejtuesit brenda dhe jashtë vendit. Gjatë takimeve të Nait Hasanit me Sokol Bashotën në Prishtinë e Tetovë, të Naitit me Azem Sylën në Tiranë të Azem Sylës me Xhavit Halitin dhe Ali Ahmetin në e Zvicër, u mor vendimi përfundimtar për formimin e strukturave ushtarake dhe organeve drejtuese të saj (Shtabi Qendror dhe ai Operativ).¹⁵

Vendim i rëndësishëm për luftën në vazhdim ishte formimi i Fondit “Vendlindja thërret” në vitin 1993. Kryetar i fondit u caktua Jashar Salihu. Nga fillimi e deri më 17 nëntor të vitit 1994, aktiviteti ishte orientuar kryesisht në krijimin dhe në organizimin e strukturave ushtarake.

¹² B. Etemaj, “Flet Ramadan Avdiu, veprimtar i hershëm i çështjes kombëtare ...”; Nait Hasani, “Të vdesim si burrat dhe, kur të shtien në ne, do të thërrasim: “Rroftë pavarësia e Kosovës”, në *Zëri*, Prishtinë, shtator-tetor 2002. Intervista është botuar në *Libri i Lirisë*, Prishtinë: Zëri, 2003, f. 144.

¹³ Ramadan Avdiu, intervistë dhënë autorit.

¹⁴ E. Xhemaili, *20 vjet veprimtari ...*, (faqja e internetit, Lpk -Kosova.com).

¹⁵ N. Hasani, “Të vdesim si burrat ...”, në *Libri i Lirisë ...*, (2003) f. 144.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës 1994-1997

Në mbledhjen e Kryesisë së LPK-së, mbajtur në qytetin Aarau në Zvicër, më 17 nëntor 1994, u vendos të lëshohej komunikata e parë ushtarake (komunikata ishte vendosur të mbajë nr. 11). Gjithashtu, duke pasur parasysh propozimet e grupimeve ushtarake në terren, u mor vendim që organizmi i ri ushtarak të quhej “Ushtria Çlirimtare e Kosovës”.¹⁶ Në këtë mbledhje ishin të pranishëm Fazli Veliu, Gafurr Elshani, Emrush Xhemajli, Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, të cilët kanë përcaktuar edhe emërtimin e UÇK-së.¹⁷ Nga kjo kohë, njësitë guerile që ekzistonin në Kosovë u shkrinë dhe u bashkuan me një emër, organizim, komandë dhe një Shtab Qendror (të Përgjithshëm) të vetëm dhe me një Shtab Operativ, që kanë organizuar dhe drejtuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Shtabi Qendror i UÇK-së u themelua në vitin 1994. Anëtarët e parë të shtabit ishin: Azem Syla, Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, Jashar Salihu, Nait Hasani, Xheladin Gashi e Sokol Bashota. Komandant i UÇK-së u emërua Azem Syla,¹⁸ kurse shef i Shtabit Operativ (brenda në Kosovë) u caktua Nait Hasani.¹⁹ Në Prishtinë, në mars-prill të vitit 1995, u krijua Shtabi Operativ në nivel të Kosovës (plotësimi i tij u bë në dhjetor të këtij viti). Anëtarë të Shtabit Operativ ishin: Nait Hasani, Rexhep Selimi, Zahir Pajaziti, Lahi Brahimaj, Sokol Bashota, Bislim Zogaj.²⁰ Sipas Nait Hasanit, Adem Jashari ishte anëtar i Shtabit Operativ, por për shkaqe objektive, nuk merrte pjesë në takimet e tij. Nait Hasani shkante e kontaktonte atë në Prekaz.²¹ Shtabi Operativ selinë e kishte në Prishtinë, por kishte edhe shumë baza të tjera ndihmëse si në Dyflakë (Divjakë),

¹⁶ E. Xhemaili, *20 vjet veprimtari ...*, (faqja e internetit, Lpk-Kosova.com).

¹⁷ Xh. Haliti, “Si e bëmë UÇK-në ...”, f. 42.

¹⁸ Po aty; N. Hasani, “Të vdesim si burrat ...”, në *Libri i Lirisë ...*, (2003), f. 145; Rexhep Selimi në gazetën javore “Zëri”, dt. 9 tetor 1999, thotë: “Azem Syla ka qenë komandant i UÇK-së që nga fillimi e deri në ndërrimet që u bënë gjatë Konferencës së Rambouillet”.

¹⁹ Xh. Haliti, “Si e bëmë UÇK-në ...”, f. 42. Po në këtë faqe, Haliti mes të tjerash, thotë: “Nait Hasani ka qenë njeriu kryesor në Kosovë, deri në arrestimin e tij. Ai ishte koordinues i të gjitha veprimeve në Kosovë dhe lidhje ndërmjet UÇK-së jashtë e brenda”.

²⁰ N. Hasani, “Të vdesim si burrat ...”, në *Libri i Lirisë ...*, (2003), f. 145.

²¹ Po aty; Nait Hasani, intervistë dhënë autorit, viti 2006.

Flamuras (Sankofc) e Komoran (Kamaran).²² Në vitin 1995 u arritën rezultate edhe në strukturimin e UÇK-së dhe shtrirjen e saj në tërë territorin e Kosovës. Nga kjo kohë u njohën organet dhe personalitetet drejtuese, të cilët midis tyre njiheshin vetëm përmes pseudonimeve.

Konferenca e Dejtonit, e mbajtur në nëntor 1995, ishte në mesin e katalizatorëve nxitës për shtimin e veprimeve të UÇK-së. Kosova nuk u ftua në konferencë,²³ dhe çështja e saj nuk u shtrua fare atje. U krijua bindja se kjo mund të arrihej vetëm me presionin mbi Perëndimin, dhe se lufta ishte ajo që e sillte vëmendjen e Fuqive Perëndimore drejt Kosovës.²⁴ Dejtoni ishte këshilla më e mirë se i duhej dalë zot vetvetes, ai ishte thirrja më e fuqishme për të luftuar kundër Serbisë, ishte mesazh për UÇK-në se “nëse shqiptarët donin të bëheshin pjesë e konferencave të tilla dhe të forconin shtetin, duhet të luftonin për liri, sepse ajo nuk falet.”²⁵

Në këtë kohë filloi organizimi, masivizimi dhe shtrirja e UÇK-së, formimi i njëjësive guerile në tërë territorin e Kosovës. Në periudhën shkurt-prill të vitit 1996 koordinimi arriti në një nivel të lartë dhe kjo vërehej përmes aksioneve të organizuara në tërë territorin e Kosovës.²⁶ Ky organizim u arrit ngaqë tani funksiononte Shtabi Operativ, i cili organizonte gjithë veprimtarinë e UÇK. Viti 1996 është viti i masivizimit të UÇK-së dhe dëshmi se ajo ishte faktor i rëndësishëm dhe i gatshëm për të marrë mbi supe përgjegjësinë politike e ushtarake në çlirimin e vendit dhe çuarjen e procesit drejt vetëvendosjes.

Gjatë zhvillimit të saj, UÇK pati vështirësi dhe pësoi disa goditje nga forcat policore serbe të cilat ishin të dhimbshme por edhe shtuan

²² N. Hasani, “Të vdesim si burrat ...”, në *Libri i Lirisë ...*, (2003), f. 145.

²³ Beqir Meta, “Lufta e Kosovës në kancelaritë perëndimore dhe vendi që zë familja Jashari në këtë luftë”, kumtesë mbajtur në Konferencën shkencore ndërkombëtare *Jasharajt dhe lufta çlirimtare*, organizuar më 6 mars 2018 nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, Instituti i Historisë, Tiranë dhe Instituti për Trashëgimi Kulturorë e Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup.

²⁴ Wolfgang Petrisch & Robert Pihler, *Rruga e gjatë në luftë - Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989-1999*, Prishtinë: Koha, 2002, f. 79-85; Tim Judah, *Kosova, luftë dhe hakmarrje*, Prishtinë: Koha, 2002 (Tiranë: ShLK, 2002), f. 154-160; Blerim Shala, “Lufta diplomatike për Kosovën”. Dialog me ambasadorin Christopher Hill, Wolfgang Petrisch dhe Robert Pihler, në Wolfgang Petrisch & Robert Pihler, *Rruga e gjatë në luftë - Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989-1999*, Prishtinë: Koha, 2002, f. 79-85.

²⁵ N. Hasani, “Të vdesim si burrat ...”, në *Libri i Lirisë ...*, (2003), f. 149.

²⁶ Rexhep Selimi, “Dhjetëshi i UÇK-së”, “Zëri”, Prishtinë, shtator 1999-tetor 2002. Intervista është botuar në *Libri i Lirisë*, Prishtinë: Zëri, 2003, f. 255; Rexhep Selimi, intervistë dhënë autorit, viti 1999.

autoritetin dhe krenarinë e saj, ato shërbyen për një mobilizim më të madh për plotësimin e misionit dhe detyrave që UÇK kishte marrë përsipër. Pas aksioneve spektakolare në nivel të gjithë vendit, të cilat ndikuan në ndryshimin pozitiv të qëndrimeve politike ndaj Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare (pavarësisht politikës “legale” të Kosovës), filluan arrestimet, ndjekjet dhe rëniet e drejtuesve të UÇK-së në ballafaqimin me forcat serbe.²⁷ Arrestimi i Nait Hasanit dhe pjesëtarëve të tjerë, rënia më 31 janar 1997, e luftëtarëve të parë të UÇK-së, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, ishin një grusht i rëndë për UÇK-në.²⁸ Këto humbje bashkëluftëtarët e tyre i kthyen në mobilizim dhe zgjerim të radhëve të saj.²⁹

Nga mesi i vitit 1997, UÇK-ja, përkundër humbjeve që përjetoi në fillim të këtij viti, arriti të shtrihet në tërë territorin e Kosovës. Kujdes i madh i kushtoj në këtë kohë furnizimit me material ushtarak-luftarak si dhe zgjerimit të radhëve të saj. Ndërkohë në kufirin shqiptaro-shqiptar ishin duke hyrë luftëtarë për t’iu bashkëngjitur radhëve të UÇK-së, të cilët njëherit bartnin armatim. Më 5 maj 1997, në pritën e forcave ushtarake serbe kundër këtyre luftëtarëve u vra Luan Haradinaj, luftëtar i orëve të para të UÇK-së, bashkëluftëtar i Zahir Pajazitit e bashkëthemelues i strukturave të para të furnizimit të UÇK me armatim dhe i logjistikës.³⁰ Rënia e tij u kthye në një simbol mobilizimi. Vëllai i tij Ramush Haradinaj u bë shembull i qëndrësës shpirtërore dhe i respektit për luftëtarin e lirisë. Gjesti i tij u bë kushtim për mobilizim duke pohuar se lufta sjell dhimbje, por ato duhen tejkualuar me vlerën e qëllimit të saj. Rrugëtimin e tij e vazhduan bashkëluftëtarët e tjerë për të përmbushur premtimin se kufiri do të shndërrohej thjesht në një kujtim të së kaluarës. Adrian Krasniqi, Ilir Konushëfci dhe shumë luftëtarë të lirisë do të bëheshin shembuj të tjerë të sakrificës dhe të amanetit të Luan Haradinajt.

²⁷ Gafurr Elshani, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës - Dokumente dhe Artikuj*, botimi i tretë, Prishtinë: Zëri i Kosovës, 2003, f. 117, 118.

²⁸ Rustem Mustafa, “Kështu luftohet, vdiset dhe jetohe për atdhe”, në *Ekskluzive*, Lugano (Zvicër): prill 2000, f. 29; Rexhep Selimi, “Dhjetëshi i UÇK-së”, në *Zëri*, Prishtinë, 9 tetor 1999, f. 8; G. Elshani: *Ushtria Çlirimtare e Kosovës ...*, (botim i tretë), f. 145.

²⁹ G. Elshani, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës ...*, (botim i tretë), f. 127.

³⁰ Bedri Islami, “Gjashtë enigmat e një vrasjeje të trefishtë”, në *Epoka e Re*, Prishtinë, 26 janar 2006, f. 10.

Në kohën kur UÇK-ja shtrihej në çdo anë të Kosovës, kur furnizimi me armatim po ecte në një rrjedhë pozitive, kur luftëtarët ndienin forcën dhe sigurinë në luftën që kishin filluar, gjatë një sulmi mbi stacionin policor në Kliçinë të Pejës, në natën mes 15 e 16 tetorit, ra heroikisht në krye të detyrës Adrian Krasniqi, luftëtar i parë me uniformën e UÇK-së. Në këtë aksion morën pjesë Ilir Konushefci, Mujë dhe Adrian Krasniqi dhe Qerim Kelmendi.

Aksionet e mirëkoordinuara të UÇK-së në këtë kohë në gjithë Kosovën e sidomos në Drenicë, Llap, Dukagjin etj., bënë që shumë territore të ishin vende të pashkelura për policinë serbe, veçanërisht trekëndëshi Klinë – Skënderaj - Drenas (Gillogovc). UÇK tani ishte në çdo vend. Kontakti me masën, ditën gjatë kontrollimit të autobusëve, automjeteve, ndalje që kishte për qëllim efektin psikologjik te popullata e arriti efektin e dëshiruar. Filluan të krijoheshin edhe legjenda rreth luftëtarëve, rreth heroizmave dhe luftimeve të tyre kundër forcave serbe.

Dalja publike e UÇK-së

Gjysma e dytë e vitit 1997 pasoi me daljen publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pas luftimeve të para frontale në betejën e Rrezallës së Re (Ludoviqit) më 26 nëntor 1997.³¹ Beteja e Rrezallës dhe dalja publike e UÇK, më 28 nëntor 1997 gjatë ceremonisë së varrimit të mësuesit Halit Geci në Llaushë të Drenicës, ishin shumë domethënëse. Përfundimisht u shuan dyshimet e trillimet e përhapura nga shtypi mbi ekzistencën dhe qëllimin e UÇK-së.³² Beteja e Rrezallës dhe dalja publike e UÇK-së u bënë kushtrim për luftën çlirimtare të Kosovës, e cila po fillonte dhe do të përhapej në çdo anë të Kosovës.

Fundi i vitit 1997 dhe fillimi i vitit 1998 ishin tregues i sukseseve të organizimit të strukturës komanduese të UÇK-së. Në janar 1998, fillojnë provokimet e forcave serbe. Më 22 janar u krye sulmi mbi familjen Jashari, të cilit Jasharajt iu kundërvunë, duke treguar gatishmërinë e tyre. Më 28 shkurt 1998 filloi beteja e Likoshanit, në vendin e quajtur “gjashtë lisat”, ku forcat serbe pësuan humbje njerëzore dhe materialo-teknike. Në tërheqje e sipër, serbët ushtruan dhunë të ashpër mbi popullatën e Çirezit dhe Likoshanit duke vrrarë dhe masakruar 24 veta.

³¹ Sylejman Selimi, “Kjo ishte lufta jonë”, në *Zëri*, Prishtinë, shkurt 2003. Intervista është botuar në *Libri i Lirisë*, Prishtinë: Zëri, 2003, f. 180, 181.

³² Koment: “Provokimi luftënxitës”, në *Rilindja*, Tiranë, 4 shkurt 1997, nr. (12.261) 28, f. 1.

Sakrifikimi dhe heroizmi legjendar i familjes Jasharaj u bë kushtrim për të gjithë kombin shqiptar dhe tronditi opinionin liridashës e përparimtar. Adem Jashari dhe familjarët e tij u etiketuan si “Simboli i UÇK-së”, “Legjenda e Kombit Shqiptar.”

Lidhur me sakrificën sublime të kësaj familjeje agjencia “Kosova Press” shkruante se kjo ngjalli kujtesën e luftërave të paepura dhe sakrificave mbi njëshekulllore të shqiptarëve kundër sundimit serb. *“Kësaj kujtese iu rikthye fanitja për trimat e Arbënisë së Vogël, vetëm atëherë kur lubisë serbe i doli përballë, si fantazmë tmerruese, uniforma e UÇK-së. Vetëm atëherë këmbët e pushtuesve, sikur ato të të parëve të tyre dikur, filluan të ndiejnë dridhjen nën këmbë, të tokës arbërore. Prandaj, lubia serbe kishte provuar disa herë ta kafshonte Drenicën, në Prekaz, në Llaushë, në Likoshan, në Çirez e sërish në Prekaz. Më 5 mars, ajo po rikthehej edhe një herë te Prekazi i legjendave të trimërisë, për ta kafshuar helmueshëm Drenicën. Po sulmohej kështjella e Jasharajve, ku prehej nderi shqiptar. Ajo kishte brenda zemrën e madhe të Komandantit Legjendar të luftës për liri, Adem Jasharit, plakun fisnik Shaban Jasharin, trimin e paepur Hamzë Jasharin, nipat dhe mbesat e Shotës. Mëngjesi i asaj dite të acartë marsi, bashkë me krismat dhe zjarrin e topave, po derdhte mbi Prekaz edhe tërë llahtarin e barbarisë serbe. Por, atë çast, brenda kështjellës u mor vendimi i madh: Nëse duhet vdekur dikush, më mirë unë sesa Kosova ime, kishte thënë Komandanti. Nëse duhet vdekur dikush, më mirë të gjithë ne sesa Atdheu, kishin thënë të gjithë Jasharajt në Kështjellë. Po shkrepnin pushkët e po këndonte zemra shqiptare. Pushka dhe kënga e trimave po shkruanin simfoninë e qëndresës së pamposhtshme. Jehona e tyre po prekte rrënjët dhe majën e historisë së luftës për liri. Në Prekaz po bëhej historia. Kështjella e Jasharajve po bëhej muranë e lirisë...”*³³

Kjo ngjarje e madhe, e cila do të bëhej legjendë bashkëkohore, për popullin shqiptar dhe do të kishte jehonë në opinionin ndërkombëtar, tregonte se UÇK me vendosmëri po merrte përgjegjësinë për fatin e Kosovës dhe se përmes saj Kosova po i dëshmonte botës se kishte marrë vendimin që të sakrifikonte gjithçka për lirinë. Pas kësaj do të rritej

³³ Agjencia e lajmeve “Kosovapress”, komenti “Pushka dhe kënga e asaj dite-simfoni e qëndresës shqiptare”, 5 mars ‘99.

përkrahja e Perëndimit me në krye SHBA për Kosovën dhe bindja se ajo e meritonte lirinë.³⁴

UÇK po ecte drejt organizimit, strukturimit, masivizimit, krijimit të aleatëve dhe çlirimit të vendit nga hordhitë serbe. Në rrugëtimin e UÇK-së, e rëndësishme ishte emblema e cila u dizenjua dhe filloi të prodhohet në fillimin e marsit të vitit 1998. Ajo do të identifikonte luftëtarët e lirisë në beteja deri në çlirim.³⁵ Më 27 prill 1998, përmes deklaratës politike, e cila u botua në shtypin vendor më 29 prill, UÇK njoftoi opinionin vendor dhe ndërkombëtar me programin politik të saj.³⁶ Përmes kësaj deklarate ajo shpalli programin e vet politik dhe ushtarak, dhe u kërkoi faktorëve politikë vendorë dhe ndërkombëtarë që ta mbështesnin luftën e saj kundër pushtetit të instaluar serb në Kosovë.

Pas luftimeve dhe betejave që u shtrinë në tërë territorin e Kosovës, SHP i UÇK-së, organi udhëheqës i cili komandonte dhe kontrollonte veprimet luftarake, i cili ishte i respektueshëm për të gjitha njësitet, nga skuadra, toga, kompania, batalioni, brigada e zonat, filloi profilizimin dhe ndarjen e detyrave.

Më 11 qershor 1998, SHP i UÇK-së, përmes Komunikatës nr. 3, shpalli se zëdhënës i saj ishte Jakup Krasniqi, dhe njëkohësisht filloi të bëjë publik emrat e anëtarëve të tij.³⁷ Komandant i SHP të UÇK-së vazhdonte të ishte Azem Sylja, zëvendëskomandant Sokol Bashota, inspektor gjeneral Rexhep Selimi, kryeshef i Drejtorisë së Informimit Hashim Thaçi, kryeshef i Drejtorisë së Shërbimit Informativ Kadri Veseli, kryeshef i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave Lahi Brahimaj, kryeshef i Drejtorisë për Pushtet Civil dhe zëdhënës i SHP të UÇK-së Jakup Krasniqi, kryeshef i Drejtorisë së Logjistikës dhe Furnizimit, Xhavit Haliti.³⁸

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (SHPUÇK), për të rritur shkallën e organizimit dhe komandimit, më 4 dhe 23 korrik

³⁴ <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, Prishtinë, 27 janar 1999.

³⁵ Bedri Islami, *Shansi i fundit në fillim të shekullit*, Prishtinë: Epoka e Re, 2003, f. 34-42.

³⁶ Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Prishtinë: Gjon Buzuku, 2006, f. 83, <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 29 prill 1998.

³⁷ <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm/> 12 qershor 1998.

“Deklaratë politike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, me nr. 3, Prishtinë, 12 qershor 1998.

³⁸ Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Prishtinë: Gjon Buzuku, 2006, f. 90.

1998, nxori Rregulloret e Përkohshme. Më 4 korrik u mor vendimi për formimin e njësave deri në kompani, kurse më 23 korrik u aprovua rregullorja e përkohshme e nënrepartëve të zbulimit në luftë.³⁹ Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së edhe njëherë, përmes zëdhënësit të tij, e ftoi opinionin e brendshëm dhe ndërkombëtar në luftë të përbashkët kundër forcave dhe aparatit serb të instaluar në Kosovë.⁴⁰

Në fazën e luftës, duke patur parasysh gjendjen e krijuar në Kosovë, UÇK e pa të domosdoshme krijimin e institucioneve gjithëpërfshirëse të spektrit politik. Gjithashtu, me qëllim të bashkërendimit të veprimtarisë politike në rrafshin kombëtar dhe pengimin e spekulimeve në këtë rrafsh, SHP i UÇK-së bëri publik emrat e përfaqësuesve politikë të saj (Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti, Faton Mehmetaj dhe Sokol Bashota).⁴¹ Adem Demaçit i dha besimin e plotë udhëheqës në këtë proces dhe për formimin e institucioneve të Kosovës. (Asamblesë Kombëtare).⁴²

Pas rritjes së shkallës së organizimit të saj, me shtrirjen e luftës në pjesën më të madhe të Kosovës, me qëllim të krijonte strukturat komanduese dhe njësave operative, më 16-17 gusht 1998, UÇK vendosi të kalojë në nivelin e organizimit në brigada. Profilizimi i SHP të UÇK-së publikimi i personaliteteve drejtuese krijoi mundësinë e kontakteve me përfaqësues të ndryshëm diplomatikë, paraqitjes së qëllimit të luftës së UÇK-së, respektimit të normave dhe konventave ndërkombëtare të luftës, duke e vënë çështjen e Kosovës në agjendat e diplomacisë ndërkombëtare.⁴³

Bashkësia ndërkombëtare, intensifikoi përpjekjet diplomatike fillimisht përmes “diplomacisë fluturuese” (shuttle diplomacy). Më 8 tetor 1998, u zhvillua takimi i Londrës, i mbajtur në aeroportin “HITHROI”, me pjesëmarrës: Rubin Cook, Hubert Vedrine, Klaus Kinkel, Madeleine Albright, Richard Holbrooke, Igor Ivanov dhe përfaqësues të OSBE-së, gjithsej 50 pjesëmarrës.⁴⁴ Më tej, u miratua

³⁹ *Po aty*, f. 93.

⁴⁰ <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, Prishtinë, 28 korrik 1998.

⁴¹ B. Etemaj, “Flet Ramadan Avdiu, veprimtar i hershëm i çështjes kombëtare ...”.

⁴² <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 13 gusht 1998. “Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)”, “Drejtoria Politike”, “Deklarata politike nr.7”.

⁴³ B. Meta, “Lufta e Kosovës në kancelaritë perëndimore dhe vendi që zë familja Jashari ...”, f. 7.

⁴⁴ T. Judah, *Kosova luftë dhe hakmarrje ...*, f. 226.

plani ajror i quajtur OPLAN 10601-FORCAT ALEATE nga ana e Këshillit të Atlantikut të Veriut⁴⁵ dhe, pas një presioni të vazhdueshëm e kërcënues, më 13 tetor, pas takimeve Richard Holbrooke - Slobodan Millosheviq, u arrit një marrëveshje, sipas së cilës policia dhe ushtria serbe në Kosovë do të ktheheshin në nivelin e paraluftës. U vendos që në Kosovë të silleshin rreth 2000 vëzhgues ose verifikues, siç u quajtën, nën emrin e OSBE-së dhe që NATO të bënte fluturime mbikëqyrëse mbi Kosovë, për të verifikuar realizimin e marrëveshjes. Derisa Holbrooke nënshkruante marrëveshjen me Millosheviqin, Këshilli i Atlantikut të Veriut i dha mbështetje, duke miratuar një Urdhër Aktivizimi (Actord) sipas të cilit, nëse nuk arrihej marrëveshja, bombardimi do të fillonte brenda 96 orësh.⁴⁶ Kryetar i KVM (Misioni Verifikues në Kosovë) ishte caktuar diplomati amerikan William Walker.

Pavarësisht se nuk ishte palë nënshkruese e marrëveshjes Holbrooke-Millosheviq, UÇK shpalli vetëpërmbytje,⁴⁷ e cila gjatë kësaj kohe, përveç hapave të suksesshëm diplomatikë, tregoi rritje edhe në strukturimin e organeve drejtuese-komanduese.⁴⁸ I rëndësishëm ishte vendimi i 10 nëntorit, kur SHP i UÇK-së, gjegjësisht Drejtoria Operative, caktoi shifrimet e ndërlidhjes në Nënzona Operative (NZO),⁴⁹ që ishte një hap në centralizimin, komandimin më efikas në tërë territorin e Kosovës. Pastaj, hap tjetër përpara në drejtim të organizimit, strukturimit dhe ngritjes së nivelit të komandimit ishte edhe vendimi i SHP të UÇK-së, i

⁴⁵ *Po aty*, f. 229.

⁴⁶ *Po aty*, f. 231; W. Petrisch & R. Pihler, *Rruga e gjatë në luftë ...*, f. 129-130.

⁴⁷ Jakup Krasniqi, *Kthesa e madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, Prishtinë: Gjon Buzuku, 2006, f. 157.

⁴⁸ Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte organi më i lartë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe kryente komandimin e përgjithshëm në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ai ishte përgjegjës për ngritjen e një ushtrie çlirimtare të përbashkët e të njësuar me njësi kryesore zonat operative, të cilat duhej të ishin të afta për të realizuar misionin e vet, çlirimin e Kosovës. Shtabi i Përgjithshëm vepronte si shtab i bashkuar i zonave operative, ishte përgjegjës për përgatitjen e shkollimeve dhe stërvitjeve individuale e të përbashkëta ushtarake/luftarake për të gjithë luftëtarët e UÇK-së/zonat operative, si dhe ishte përgjegjës për përgatitjen dhe komandimin e veprimeve ushtarake/luftarake në luftën çlirimtare. Duke pasur parasysh se shtabi duhet të funksiononte si një trup kompakt, me staf profesionist, i cili njihte detyrat, përgjegjësit dhe kompetencat e tij, UÇK-ë, ndërtoi një strukturë të shtabit të përgjithshëm i cili mbajti bashkërendim dhe bashkëpunim të shkallës së lartë si brenda vetes ashtu edhe me shtabet e njësisive më të ulëta, si shtabet e zonave operative.

⁴⁹ A.Z5M.TMK, D-UÇK, SHP i UÇK-së pa nr., dt. 10.11.1998.

datës 18 nëntor 1998, sipas të cilit kalohej nga organizimi i Nënzonave Operative të UÇK-së në Zona Operative.⁵⁰ Deri në nëntor të vitit 1998 Kosova ishte një Zonë Ushtarake e UÇK-së, e organizuar në 7 Nënzona Operative: NZO e Drenicës, NZO e Pashtrikut, NZO e Dukagjinit, NZO e Shalës, NZO e Llapit, NZO e Nerodimes dhe NZO e Karadakut.⁵¹ Zonat Operative të UÇK-së ishin njësi operative në terren, përmes të cilave Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së mbulonte tërë territorin e Kosovës. Zonat Operative kishin hierarkinë/strukturat komanduese dhe territorin e përgjegjësisë së tyre. Për nga strukturimi dhe organizimi në terren, krahasuar me organizimet e tjera ushtarake, zonat operative të UÇK-së kishin një organizim dhe strukturë të një Divizioni standard ushtarak. UÇK kishte gjithsej shtatë zona operative. Zonat Operative të UÇK-së, kishin si organ më të lartë të komandim- kontrollit Shtabin (Komandën) e Zonës, përmes së cilës komandoheshin njësitë taktike siç ishin brigadat, batalionet, njësitë speciale, njësitë pranë shtabit. Secila zonë operative në territorin e përgjegjësisë së saj kishte nga dy deri në tetë brigada.⁵²

Me rëndësi të veçantë ishte paraqitja dhe pranimi në arenën ndërkombëtare e diplomatike e UÇK-së si faktor i rëndësishëm dhe vendimtar në proceset politike dhe ushtarake për Kosovën. Për faktin se UÇK ishte një organizatë politiko-ushtarake, e cila kishte fituar simpati dhe përkrahje, dhe se SHP i UÇK ishte bërë qendër e bisedimeve, dëshmojnë edhe deklaratat e zyrtarëve të ndryshëm: Emisari special amerikan për zgjidhjen e krizës në Kosovë, Richard Holbrooke, deklaroi në Krans Montana: *“Liderët e kryengritësve shqiptarë në Kosovë do të duhej të kyçeshin në përpjekjet për zgjidhjen paqësore të problemit*

⁵⁰ *Po aty*, nr. 442-2/091 dt. 19.11.1998.

⁵¹ Sipas vendimit të 18 nëntorit të vitit 1998, u caktuan këto Zona Operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Zona Operative e Drenicës (zona e parë), Zona Operative e Pashtrikut (zona e dytë), Zona Operative e Dukagjinit (zona e tretë), Zona Operative e Shalës (zona e katërt), Zona Operative e Llapit (zona e pestë), Zona operative e Nerodimes (Nerodimes) (zona e gjashtë) dhe Zona Operative e Karadakut (zona e shtatë).

⁵² Brigadat e Zonave Operative, në territorin e përgjegjësisë së veprimit, si njësi taktike, në strukturën e tyre kishin deri në katër batalione; batalionet përbëheshin nga tri deri në katër kompani; kompanitë përbëheshin nga tri deri në pesë toga; togat përbëheshin nga tri deri në pesë skuadra; ndërsa skuadrat përbëheshin nga tetë deri në dhjetë ushtarë. Të gjitha njësitë vepronin në zinxhirin komandues në gjithë strukturën organizative të UÇK-së. Nga maji i vitit 1999, në të gjitha Zonat Operative të UÇK-së u themeluan batalionet gardiste. Këto batalione kishin për mision dhe detyrë ndërhyrjet e shpejta dhe sulmuese.

*kosovar, po qe se dëshmojnë se kanë kontrollin mbi luftëtarët në terren. Po qe se liderët e kryengritësve shqiptarë në Kosovë argumentojnë se kanë ndikimin e tyre tek luftëtarët e UÇK-së, mendoj se ata duhet të luajnë rolin e tyre legjitim në proceset paqësore”.*⁵³ Janusz Bugajski, ekspert i Qendrës për Studime Ndërkombëtare në Uashington, theksonte: “UÇK-ja është bërë një forcë që duhet parë si palë e mundshme në negociatat për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. UÇK, si forcë, po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, si politikisht, ashtu edhe ushtarakisht. Koha po tregon se Millosheviqi kurrë nuk i ka filluar bisedimet i shtyrë nga dëshira por vetëm nga forca. Është me shumë rëndësi që forcat e NATO-s të fillojnë bombardimet e disa objekteve strategjike serbe, pasi kështu ka të ngjarë që presidenti jugosllav të pranojë të hyjë në bisedime serioze me shqiptarët e Kosovës. Vendosja e kontakteve me UÇK-në dhe mundësia e pjesëmarrjes së saj në negociata është parë nga ekspertët e çështjeve ballkanike në SHBA si një ndryshim me rëndësi në qëndrimin amerikan ndaj çështjes së Kosovës”.⁵⁴ Zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, James Rubin, në konferencën e rregullt për gazetarë, tha: “SHBA-të nuk kanë asgjë kundër që në bisedimet e ardhshme shqiptaro-serbe, në delegacionin e shqiptarëve të Kosovës të paraqiten pikëpamjet e përfaqësuesve të UÇK-së”.⁵⁵

Lufta e UÇK-së dhe mirëpritja e saj në arenën ndërkombëtare pasoi me takimet e shefit të Drejtorisë Politike, Hashim Thaçi, me përfaqësues të diplomacisë ndërkombëtare. Në këtë kuadër ishte edhe takimi me Christopher Hill, në selinë e KDOM-it amerikan në Dragobil, më 6 nëntor 1998, në të cilin UÇK-në e përfaqësonin Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja. Në takim u diskutua rreth projektit të Ch. Hillit për Kosovën. Në të ishte i pranishëm edhe shefi i KDOM-it amerikan, Sean Burns.⁵⁶ Në mesin e nëntorit në Malishevë, u zhvillua takimi me Wolfgang Petrisch, ku UÇK përfaqësohej nga H. Thaçi dhe F. Limaj. Pas caktimit të grupit që do të zhvillonte takimet me ndërkombëtarët, i udhëhequr nga Jakup Krasniqi, janë mbajtur edhe disa takime në Dragobil, si me Ch. Hill dhe me Lary Rossin. Takimet e lartshënuara dëshmonin për zhvendosjen e bisedimeve nga Prishtina në SHP të UÇK-

⁵³ <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 29.06.1998.

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ *Po aty*, 21.07.1998.

⁵⁶ *Po aty*, 7.11.1998; J. Krasniqi, *Kthesa e madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës ...*, f. 147.

së. Kjo tregonte gjithashtu se UÇK po respektohej nga faktori ndërkombëtar dhe po pranohej si faktor vendimtar për çështjen e Kosovës.

Në kuadër të gjithë këtij aktiviteti diplomatik, ushtarak e, mbi të gjitha, në rrethana lufte, SHP i UÇK-së, më 12 nëntor 1998, me qëllim të përmirësimit të funksionimit, komandimit dhe kontrollit, plotësoi strukturën e vet komanduese. Përveç Drejtorisë Politike, e cila ishte e plotësuar, në këtë kohë SHP i UÇK-së kishte këtë strukturë: Komandanti kishte dy zëvendëskomandantë, zv.komandant për operacione dhe zv.komandant për mbështetje; Inspektori gjeneral, kabineti i komandantit, dhe shefi i Shtabit, që komandonte përmes disa strukturave që quheshin drejtori. (Drejtoria e Personelit, Drejtoria e Shërbimit Informativ, Drejtoria Operative, Drejtoria e Logjistikës, Drejtoria e Marrëdhënies Publike dhe Administratës Civile, Drejtoria e Komunikimit dhe Ndërlidhjes, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoria e Informimit Publik dhe Drejtoria e Policisë Ushtarake).⁵⁷ Pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, funksiononin disa njësite si: Batalioni Diversant Vëzhgues, Batalioni i Policisë, Kompania e Logjistikës, Departamenti i Mjekësisë, Kompania e Komunikimit, Brigada 60, Fondi “Vendlindja thërret”, Trupa Artistike Ushtarake “Hamëz Jashari”, si dhe Batalioni “Atlantiku”. Një armë e fuqishme iu shtua UÇK-së më 4 janar, kur filluan nga puna dy institucionet e rëndësishme informative: Agjencia e lajmeve “Kosovapress” dhe radiostacioni “Kosova e Lirë”. Duke vlerësuar rolin e këtyre strukturave të reja në luftën çlirimtare, Jakup Krasniqi deklaronte: *“Këto institucione kanë për detyrë e qëllim për t'i dhënë zërin meritort pushkëve të lirisë, që me zë e shkrime të njoftojnë opinionin e brendshëm e të jashtëm për luftën e drejtë çlirimtare të popullit dhe ushtrisë së tij, për t'i treguar sukseset e luftës në tërë Kosovën, për të bërë të njohur strategjinë tonë liridashëse. Kjo punë që po nis sot është edhe një dëshmi tjetër se UÇK-ja seriozisht e synon lufton për lirinë, pavarësinë e demokracinë e Kosovës, që po shkon drejt sendërtimit të aspiratës sonë kombëtare”*.⁵⁸

⁵⁷ J. Krasniqi, *Kthesa e madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës ...*, Prishtinë, f. 135; Jakup Krasniqi, *Lëvizja Politike dhe qëndresa e armatosur në Kosovë (1991-1999)*, temë magistrature, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, (pa vit), f. 59, 60.

⁵⁸ Qemal Aliu, *Agjencia e flakëve të luftës*, Prishtinë: Kosovapress, 2004, f. 13-27. Filluan punën agjencia e lajmeve “Kosovapress” dhe radiostacioni “Kosova e lirë”, “Kosova Sof”, Prishtinë, 5 janar 1999.

Lufta e drejtë çlirimtare, respektimi i konventave ndërkombëtare të luftës nga UÇK, krijimi i raporteve të afërta diplomatike midis saj dhe faktorëve ndërkombëtarë, vetëpërmbytja pas marrëveshjes Holbrooke - Millosheviq, marrëveshja për lirimin e robërve të luftës (8 ushtarët serbë të arrestuar më 8 janar në Zonën Operative të Shalës u këmbyen me 9 ushtarë të UÇK-së), dhe nga ana tjetër masakra e kryer nga forcat serbe në Reçak më 15 janar, ishin faktorë shtytës të “diplomacisë fluturuese” e cila po krijonte bindjen se çështja e Kosovës duhej zgjedhur me një ndërhyrje të përgjithshme dhe të fuqishme. Më 15 shkurt, Dr. Helena Ranta, drejtore e ekipit të mjekësisë ligjore të Bashkimit Evropian në Kosovë, vërtetoi krimin e forcave serbe në Reçak. Në raportin e saj ajo shkruante: *“Nuk kishte asgjë që tregonte se ata njerëz të ishin gjë tjetër, përveçse civilë të paarmatosur”*.

Konferenca në Rambouillet dhe përfundimi i luftës

Masakrat kundër popullsisë sivile në Likoshan më 28 shkurt 1998, në Prekaz të Ulët më 5-7 mars 1998, në Kronarb (Lubeniq) të Pejës më 25 maj 1998, në Rahovec më 19 shkurt 1998 dhe në Abri të Epërme (Obri të Epërme) më 26 shtator 1998, dhe sidomos masakra e tmerrshme në Reçak të Shtimes më 15 janar 1999, ku u masakruan 52 qytetarë shqiptarë, pa dallim moshe e gjinie, treguan fytyrën e vërtetë kriminale të regjimit të Beogradit. Të gjitha këto veprime gjenocidi ishin thirrje e fundit që bashkësia ndërkombëtare të ndryshonte qëndrimin e vet ndaj palëve në luftën e Kosovës, në mënyrë që të mos barazohej xhelati me viktimën. Mbi të gjitha, Fuqitë Perëndimore, bazuar në të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare, ndërmorën veprime të mëtejme, duke i treguar qartë politikës së Milosheviqit dhe zbatuesve të saj se përfundimisht ishte e gatshme t'i jepte fund luftës, para se kjo luftë t'i jepte fund ekzistencës së popullit shqiptar në Kosovë. Kështu, bashkësia ndërkombëtare, nëpërmjet Havier Solanës, sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, pas takimit të Këshillit të NATO-s publikoi deklaratën, përmes së cilës dënoshin aktet antinjerëzore të pushtuesit serb.⁵⁹

⁵⁹ <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 18 janar 1999. Këshilli i NATO-s dënon masakrën ndaj shqiptarëve të Kosovës, e cila është bërë në fshatin Reçak të premtën e kaluar. Kjo paraqet shkelje flagrante të ligjeve humanitare ndërkombëtare. Këshilli thërret autoritetet jugosllave që të bashkëpunojnë plotësisht me Gjykatën Ndërkombëtare të krimeve të luftës për ish-Jugosllavi, duke përfshirë edhe lejimin e

Veprimet mospërfillëse të qeverisë serbe, si në rastin e moslejimit të hyrjes në Kosovë të kryeprokurores së Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve për ish Jugosllavi, zonjën Luiz Arbur, më 19 janar 1999, të cilën e shpalli person të padëshiruar,⁶⁰ pastaj kërcënimi i shefit të Misionit Verifikues të OSBE-së, William Walker, në mënyrë ultimative që të largohet nga territori i RFJ-së; deklarata zyrtare se dy gjeneralët kryesorë të NATO-s, Klaus Nouman, kryesues i Komitetit Ushtarak të NATO-s dhe Wesley Clark, komandant suprem i forcave të NATO-s për Evropë nuk ishin të mirëseardhur për Beogradin, ishin edhe një element shtys i diplomacisë ndërkombëtare, në Washington, Paris, Londër etj., se për

menjëhershëm dhe të pakufizuar të kryeprokurores Luis Arbur dhe hetuesve ndërkombëtarë, përfshirë edhe ekspertët e Finlandës. Ne, po ashtu, thërrasim autoritetet e RFJ-së që të garantojnë sigurinë e njerëzve të Gjykatës së Hagës. Këshilli kërkon nga qeveria jugosllave që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm, në mënyrë që përgjegjësit e kësaj masakre të dërgohen para organeve të drejtësisë. Emrat e atyre që kanë marrë pjesë në vrasje dhe të atyre që kanë dhënë urdhër duhet të bëhen publik dhe duhen dërguar para organeve të Gjykatës së Hagës për gjykim, nëse kërkohet. Milosheviqi duhet t'u përmbahet të gjitha premtimeve të tij ndaj NATO-s dhe OSBE-së, të cilat janë të bazuara në Rezolutën 1199 të KS të OKB-së. RFJ-ja, forcat e veta ushtarake dhe ato të policisë speciale duhet t'i lërë në gjendjen dhe në nivelin në përputhje me premtimet që ia ka bërë NATO-s tetorin e kaluar. Si nënshkruer i kësaj marrëveshjeje, kryetari Milosheviq është përgjegjës për të siguruar se ky numër dhe nivel i forcave duhet respektuar. Ai, po ashtu është personalisht përgjegjës për sjelljet e forcave të tij të sigurimit. Këshilli i NATO-s ka marrë raporte nga kryesuesi i Komitetit Ushtarak, Klaus Nauman, dhe i forcave për Evropë të NATO-s, Wesley Clark, lidhur me situatën ushtarake dhe me gjendjen e planifikimeve ushtarake. Ai ka rikonfirmuar se "Urdhri i aktivizimit" mbetet në fuqi. Këshilli i NATO-s ka vendosur të dërgojë në Beograd kryesuesin e Komitetit Ushtarak dhe të Forcave për Evropë të NATO-s për t'ua përcjellë autoriteteve jugosllave vlerësimin mbi situatën dhe obligimet për të respektuar të gjitha angazhimet dhe premtimet dhënë NATO-s. Që të dy, Nauman dhe Clark, gjithashtu rikonfirmojnë përkrahjen e NATO-s ndaj përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për të sjellë paqen në rajon, përfshirë këtu edhe Kombet e Bashkuara, OSBE-në dhe Bashkimin Evropian. Këshilli përkrah Misionin Verifikues të OSBE-së dhe kryesuesin e tij, ambasadorin Uoker. Këshilli ka dënuar me forcë sulmin ndaj përfaqësuesve të këtij Misioni, të premtën e kaluar dhe thërret që fajtorët për këtë të dërgohen për gjykim. Këshilli insiston që RFJ-ja të respektojë obligimet e saj për të garantuar sigurinë e verifikuesve. Të dyja palët duhet të frenohen nga aksionet që vënë në rrezik verifikuesit. Në fund, NATO dënon të gjitha aktet e dhunës. Ajo thërret të dy palët që menjëherë të fillojnë bisedimet për gjetjen e zgjidhjes politike, e cila duhet të japë një autonomi të zgjeruar për Kosovën dhe njëkohësisht ruan integritetin territorial të RFJ-së.

⁶⁰ <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 18.11.1999.

arritjen e konsensusit, diplomacia e ardhshme duhej mbështetur tek kërcënimi dhe forca.⁶¹

Në këtë situatë të krijuar në terren, Këshilli i Atlantikut Verior të NATO-s më 30 janar lëshoi një deklaratë, ku theksonte se kriza ishte një “rrezik për paqen dhe sigurinë në botë”. Mes tjerash, u bënte thirrje palëve ndërluftuese që të ndërprisnin luftimet dhe t’i përgjigjeshin ftesës për bisedime, në të kundërtën do të përballeshin me forcën e NATO-s.⁶² Kështu, diplomacia ndërkombëtare vendosi të organizojë një takim ndërkombëtar për paqen në Kosovë.

Takimi për paqen u mbajt në një kështjellë, 45 km në juglindje të Parisit, në Rambouillet. Bisedimet kishin për bazë projekt propozimet për të ardhmen e Kosovës, të hartuara nga Christopher Hill dhe Wolfgang Petrisch. Këta të dy do të ishin edhe negociatorë, së bashku me rusin Boris Majorski, ndërsa Robin Cook dhe Hubert Vedrine do të ishin bashkëdrejtues të bisedimeve. Sipas Tim Judah, *“kjo ishte gjysma diplomatike e strategjisë, gjysma tjetër, përdorimi i besueshëm i forcës, u shfaq në formën e kërcënimit që u bë nga Këshilli i NATO-s”*.

Më 30 janar 1999, u mbajt në Shkup takimi ndërmjet ministrit të Jashtëm R. Cook, W. Petrisch, Ch. Hill dhe përfaqësuesve të tri grupimeve (fraksioneve) politike në Kosovë, Adem Demaçi, Ibrahim Rugova dhe Rexhep Qosja. Ndërsa Rugova dhe Qosja ishin dakorduar për pjesëmarrje, SHP i UÇK-së (me gjithë kontradiktat midis Demaçit dhe SHP të UÇK-së) më 3 shkurt, përmes Hashim Thaçit, bëri të njohur pjesëmarrjen në Rambouillet. Po më 3 shkurt u kompletua delegacioni i Kosovës për bisedimet shqiptaro-serbe në Rambouillet të Francës. Në përbërje të delegacionit ishin: përfaqësues të UÇK-së Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Azem Syla, Xhavit Haliti dhe Ramë Buja, përfaqësues të LBD-së Rexhep Qosja, Hydajet Hyseni, Bajram Kosumi dhe Mehmet Hajrizi, përfaqësues nga LDK-ja Ibrahim Rugova, Bujar Bukoshi, Idriz Ajeti, Fehmi Agani dhe Edita Tahiri, kurse Veton Surroi e Blerim Shala si personalitete të pavarura. Pas mbërritjes në Rambouillet, delegacionit të Kosovës iu bashkëngjiti një ekip këshilltarësh ligjorë, si: Morton Abramowitz, një ish funksionar i departamentit amerikan të shtetit, Paul Williams, jurist i drejtësisë ndërkombëtare me qendër në Washington,

⁶¹ T. Judah, *Kosova luftë dhe hakmarrje ...*, f. 241. (M. Albright ishte iniciuese dhe kreative e diplomacisë së fortë dhe kërcënuese ndaj Serbisë).

⁶² Skënder Zhitia, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës – Zona Operative e Llapit*, Prishtinë: Grafoprint, 2008, f. 70.

Mark Weller, specialist gjerman i së drejtës ndërkombëtare dhe Shinasi Rama, student doktore në Universitetin e Kolumbias në New York.⁶³

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, përmes deklaratës politike, të datës 6 shkurt 1999, theksoi edhe një herë para opinionit vendimin për pjesëmarrje në bisedimet ndërkombëtare në Rambouillet.⁶⁴

Konferenca Ndërkombëtare paqësore për Kosovën i filloi punimet më 6 shkurt 1999, pas orës 18:00, nën përcjelljen e më se 200 gazetarëve, si dhe dhjetëra ekipeve televizive. Konferencën, në praninë e të dy delegacioneve dhe të pjesëmarrësve të tjerë të saj, e hapi presidenti i Francës, Jacques Chirac. Në fjalën përshëndetëse, mes të tjerash, ai theksoi: *“Ka ardhur koha që, më në fund, palët në konflikt të ulen në tryezën e bisedimeve dhe të gjejnë një zgjidhje paqësore, që për popullin e Kosovës dhe rajonin e Evropës Juglindore të lindë shpresa për paqe dhe për prosperitet edhe në këtë pjesë të Evropës”*.⁶⁵ Negociatorët pastaj i përshëndeti ministri i Jashtëm britanik, R. Cook, i cili, mes të tjerash, deklaroi: *“Jemi takuar sot para syve të hapur të botës! Jemi takuar me përkrahjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Unionit Evropian dhe OSBE-së, si dhe me mbështetjen e NATO-s. Jemi këtu si përfaqësues të Grupit të Kontaktit dhe të dy palëve në konfliktin e Kosovës”*. *“Është më e lehtë të bëhet lufta sesa të arrihet paqja”*, vazhdoi Cook. *Ai mori si shembull armiqte e dikurshëm në kuadër të Unionit të sotëm Evropian dhe miqësinë e bashkëpunimit e sotëm të ngushtë mes këtyre shteteve. Si shembull konkret, ai përmendi rastin e luftërave të shumta franko-angleze dhe tashti paqen, afrinë dhe bashkëpunimin e ngushtë mes këtyre dy shteteve dhe shteteve të tjera në Evropë*.⁶⁶ Ministri i Jashtëm i Francës, Hubert Vedrine, në fjalimin përshëndetës, pos të tjerash, tha: *“Grupi i Kontaktit nuk ka synim tjetër, veçse të arrijë ndaljen e dhunës dhe një zgjidhje politike të konfliktit. Vetë prezenca e gjastë shteteve të Grupit të Kontaktit dëshmon unitetin e bashkësisë ndërkombëtare që të gjendet një zgjidhje e konfliktit dhe të arrihet një marrëveshje politike për konfliktin”*.⁶⁷

⁶³ T. Judah, *Kosova, luftë dhe hakmarrje ...*, f. 252.

⁶⁴ Agjencia e lajmeve “Kosovapress”, 6 shkurt 1999, <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 06 shkurt 1999.

⁶⁵ *Po aty*, 07 shkurt 1999.

⁶⁶ Agjencia e lajmeve “Kosovapress”, 6 shkurt 1999, <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 7 shkurt 1999.

⁶⁷ <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 7 shkurt 1999.

Përfaqësuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të Lëvizjes së Bashkuar Demokratike, të Lidhjes Demokratike të Kosovës, si dhe personalitete të pavarura, përbënin një delegacion të njësisëm, unik, të popullit të Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambouillet të Francës. Delegacionit i printe kryesia e përbërë nga Hashim Thaçi, Ibrahim Rugova dhe Rexhep Qosja. Kryesues i kryesisë ishte caktuar Hashim Thaçi,⁶⁸ kurse zëdhënës Veton Surroi. Delegacioni i Kosovës në Rambouillet tregoi një unitet dhe bashkëpunim të lartë, gjatë konferencës hartoi platformën e përbashkët politike dhe ushtarake. Delegacioni shqiptar në bisedimet e ditës së parë që pati me ndërmjetësuesit ndërkombëtarë, ambasadorin e SHBA-ve, Ch.Hill, ambasadorin e Austrisë, W. Petrisch dhe ambasadorin e Rusisë, Boris Majorski, shtroi kërkesën për arritjen e një armëpushimi mes forcave të armatosura serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i bindur se ashtu do t'i kontribuohet mirëvajtjes së bisedimeve.⁶⁹ Armëpushimi do të ishte i garantuar nga shtetet anëtare të Grupit të Kontaktit. Gjithashtu, gjatë kësaj dite mori edhe projekt dokumentet mbi statusin e Kosovës. Pala shqiptare, më 9 shkurt, formoi edhe disa komisione të punës. Në grupin politik ishin caktuar Jakup Krasniqi, Mehmet Hajrizi, Blerim Shala dhe Fehmi Agani. Në sekretari ishin caktuar Bajram Kosumi dhe Edita Tahiri. Po ashtu, ishte krijuar edhe një komision i përbashkët NATO-UÇK për përcjelljen dhe evidentimin e ngjarjeve në Kosovë, të cilin e kryesonte NATO, me përfaqësuesin Dejvid Jagostenllansig, UÇK-në e përfaqësonte Azem Syla. Ndërsa, në komisionin për informim ishin caktuar Ramë Buja e Dukagjin Gorani.⁷⁰

Delegacioni i Kosovës në ditët e para u fokusua kryesisht në kërkesën për nënshkrimin e armëpushimit.⁷¹ Gjithashtu, me kërkesën e ministrave të Punëve të Jashtme të Francës e Anglisë, H. Vedrine dhe R. Cook, u bë një takim zyrtar me kryesuesin e delegacionit shqiptar në Rambouillet, Hashim Thaçi. Po ashtu, Hashim Thaçi pati një takim edhe me ambasadorin e Francës në Austri, me kërkesën e këtij të fundit.

Delegacioni i Kosovës në Rambouillet në ditët në vazhdim u përball me presione nga diplomacia ndërkombëtare, veçmas nga ajo amerikane,

⁶⁸ B. Meta, "Lufta e Kosovës në kancelaritë perëndimore dhe vendi që zë familja Jashari ...", f. 4.

⁶⁹ Agjencia e lajmeve "Kosovapress", 7 shkurt 1999.

⁷⁰ *Po aty*, 9 shkurt 1999.

⁷¹ *Po aty*, 10 shkurt 1999.

për nënshkrimin e dokumentit final. Delegacioni i Kosovës shprehu pakënaqësi dhe mospajtueshmëri rreth çështjes ushtarake, të ardhmes së UÇK-së dhe asaj politike, mbajtjes së referendumit për pavarësi të Kosovës, pas tri vitesh.⁷² Në momentin e fundit, delegacioni i Kosovës, përmes një deklaratë të miratuar me konsensus të plotë, u pajtua në parim rreth dokumentit final.⁷³

Takimi në Rambouillet i mbylli përkohësisht punimet më 23 shkurt, për të vazhduar më 15 mars 1999, pasi që të dy palët në bisedime nuk e nënshkruan dokumentin e ofruar nga bashkësia ndërkombëtare.⁷⁴ Pikërisht më 23 shkurt, delegacioni i Kosovës në Rambouillet, pas konsultimeve të grupimeve politike dhe ushtarake: Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lëvizjes së Bashkuar Demokratike dhe përfaqësuesve të pavarur, vendosi:⁷⁵ “1) Të formohet Qeveria e Përkohshme e Kosovës; 2) Qeveria do të funksionojë deri në zgjidhjet e lira në Kosovë; 3) Mandatari i Qeverisë, me marrëveshje, do të jetë përfaqësuesi i UÇK-së; 4) Tri grupimet politike do të kenë përfaqësim të barabartë në qeveri. Këtij numri i shtohet mandatarin dhe përfaqësuesi i pavarur.” Nënshkrues të saj ishin: Hashim Thaçi, për UÇK-në, Ibrahim Rugova, për LDK-në dhe Rexhep Qosja, për LBD-në.

Përfaqësuesit e UÇK-së në delegacionin e Kosovës, pas përfundimit të Konferencës Ndërkombëtare, u kthyen në Kosovë më 25 shkurt. Ata e shfrytëzuan periudhën e ndërprerjes së bisedimeve për kontakte dhe për të njoftuar rreth dokumentit të marrëveshjes, drejtuesit e komandantët e Zonave të UÇK-së. Gjithashtu, edhe pjesëtarët e tjerë të delegacionit zhvilluan takime të ndryshme.

Në mbledhjen e 27 dhe 28 shkurtit, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, me përbërje të zgjeruar, u njoftua nga pjesëmarrësit e Konferencës Ndërkombëtare të Rambujesë për bisedimet dhe rezultatet përfundimtare të tyre, si dhe për çështje të tjera organizative dhe ushtarake. Në këtë mbledhje, me rëndësi historike, dominoi dhe fitoi fryma e unitetit dhe e bashkimit në luftën për liri, pavarësi e demokraci.⁷⁶ Në këtë mbledhje, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, në bazë të vendimit të 23 shkurtit mbi themelimin e Qeverisë së Përkohshme, caktoi edhe kryeministrin e

⁷² W. Petrisch & R. Pihler, *Rruga e gjatë në luftë ...*, f. 203.

⁷³ *Po aty*, f. 217.

⁷⁴ *Agjencia e lajmeve “Kosovapress”*, Tiranë, 23 shkurt 1999.

⁷⁵ *Agjencia e lajmeve “Kosovapress”*, Rambouillet, 24 shkurt 1999.

⁷⁶ <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 1 mars 1999.

Qeverisë së Përkohshme të Kosovës. Në mbledhje, u kërkua që dokumenti përfundimtar i paraqitur nga bashkësia ndërkombëtare të vlerësohej edhe nga ekspertët dhe intelektualët, si dhe shtresa të tjera të popullit.

Më 2 mars 1999, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës njoftoi se ka caktuar Hashim Thaçin, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe kryeshef i Drejtorisë Politike të UÇK-së, mandatar për formimin e Qeverisë së re të Përkohshme të Kosovës, e cila do të punonte për përgatitjen e zgjedhjeve të lira e të rregullta parlamentare në Kosovë. Në mbledhjen e fundit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së u caktua edhe përbërja e delegacionit të UÇK-së që do të vizitonte SHBA-të, me ftesë të Ministrisë së Jashtme amerikane. Në këtë delegacion ishin caktuar Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Ramë Buja, Bashkim Jashari, Bislim Zyrapit dhe Ramush Haradinaj.⁷⁷ Më 5 mars 1999, përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit, W. Petrisch dhe ambasadori gjerman Ch.Vols, drejtor i grupit për Kosovën, në Qëndresë (Tërstenik) u pritën nga Komandanti i Përgjithshëm i UÇK-së, Sylejman Selimi, si dhe nga anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, Ramë Buja dhe Fatmir Limaj. Ata biseduan për gjendjen aktuale në Kosovë, për qëndrimet e UÇK-së rreth Marrëveshjes së Konferencës Ndërkombëtare për zgjidhjen kalimtare të çështjes së Kosovës. Komandanti i Përgjithshëm i UÇK-së, Sylejman Selimi dhe anëtarët e tjerë deklaruan se UÇK dhe populli i Kosovës e konsideronin si pozitiv dokumentin e Rambujesë, pra si një bazë për zgjidhjen e mëtejshme të çështjes së Kosovës.⁷⁸

Pas rifillimit të bisedimeve, delegacioni i Kosovës qysh në takimin e parë shprehu miratimin për të gjithë projektin e marrëveshjes. Hashim Thaçi, në emër të delegacionit, përmes letrave dërguar Joshka Fisherit (kryesuesit të Këshillit të BE-së) dhe W. Petrisch (të dërguarit të posaçëm të BE-së), deklaronte pranimin e marrëveshjes dhe falënderonte ndërmjetësuesit për përpjekjet gjatë bisedimeve.⁷⁹ Delegacioni serb, edhe pas tri ditë bisedimesh, nuk ra dakord për nënshkrim të marrëveshjes, kryesisht kundërshtonte rreth çështjeve politike.

⁷⁷ <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 2 mars 1999.

⁷⁸ J. Krasniqi, *Kthesa e madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës...*, f. 188, <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 6 mars 1999.

⁷⁹ W. Petrisch & R. Pihler, *Rruga e gjatë në luftë - Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare ...*, f. 23, 7-238.

Në mbrëmjen e 18 marsit, delegacioni i Kosovës e nënshkroi dokumentin e marrëveshjes. Dokumentin gjithashtu e nënshkruan si dëshmitarë Wolfgang Petrisch dhe Christopher Hill, ndërsa Boris Majorski, edhe pse ishte i pranishëm, nuk e nënshkroi.⁸⁰

Dështimi politik i bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjes së Kosovës nëpërmjet bisedimeve në Konferencën paqësore, e cila u organizua nga 6 shkurti deri më 18 mars 1999, në Rambouillet të Francës, ishte fundi i përpjekjeve dhe mundësive politike e diplomatike të faktorit ndërkombëtar për ta zgjidhur krizën paqësisht. Prandaj, në rrethana të tilla, Fuqitë Perëndimore vendosën që të zgjidhin çështjen e Kosovës përmes argumentit të forcës, duke theksuar aspektin human të ndërhyrjes dhe qëllimeve për vendosjen e lirisë dhe demokracisë në Kosovë.⁸¹

Në situatën e re të krijuar, bazuar në të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare, respektivisht në katër konventat e Gjenevës të vitit 1949, si dhe Protokollit shtesë, miratuar më 1977, pas përgatitjeve operative dhe konsultave ushtarake e diplomatike, dhe pas urdhrit të sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Javier Solana, komandanti i forcave aleate të NATO-s për Evropën, Wesley Clark, më 24 mars, në orën 22:00, dha urdhër për fillimin e sulmeve ajrore kundër Serbisë.⁸² Bombardimet u kryen mbi baza ushtarake, policore e objekte përcjellëse serbe.

Gjatë bombardimeve të NATO-s, Kryeministri i Qeverisë së Përkohshme, Hashim Thaçi, pas kthimit nga Parisi, filloi të organizonte strukturat e Qeverisë së Përkohshme dhe ato ushtarake. Qeveria e Përkohshme, në mbledhjen e saj të datës 27 prill 1999, pasi bëri analizën në lidhje me zbatimin e urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm për mobilizim të përgjithshëm të popullsisë, vlerësoi se populli i Kosovës iu përgjigj asaj njëzëri. Zbatimi i këtij urdhri, si dhe largimi i një pjese të anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm pasi u ngarkuan me funksione të reja shtetërore, krijoi një situatë të re, të cilës institucionet ekzistuese legjitime në Kosovë duhet t'i përgjigjeshin me masa organizative sa më të efektshme. Lidhur me këtë çështje u morën një sërë vendimesh dhe u nxorën një sërë dekretesh. Agim Hasan Çeku u emërua shef i Shtabit të

⁸⁰ *Po aty*, f. 237, 241, 242.

⁸¹ B. Meta, "Lufta e Kosovës në kancelaritë perëndimore dhe vendi që zë familja Jashari ...", f. 2.

⁸² Wesley K. Clark, *Të bësh luftë moderne*, Prishtinë, Zëri, 2003, f. 233.

Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,⁸³ ndërsa Sylejman Selimi, komandant i Gardës Kombëtare të Kosovës.

Gjatë kohës së bombardimeve përfaqësuesit e Qeverisë së Përkohshme zhvilluan disa vizita jashtë vendit dhe shumë takime me përfaqësues të diplomacisë ndërkombëtare.

Bombardimet e NATO-s përfunduan më 9 qershor 1999, rreth orës 22:30, atëherë kur, në praninë e më shumë se 400 gazetarëve dhe kameramanëve të medieve të ndryshme nga të gjitha kontinentet, pas bisedimeve monotone në Aeroportin Sportiv “Haxhitepe” të Kumanovës, gjeneralët e Millosheviqit firmosën kapitullimin në Kosovë dhe nënshkruan planin e tërheqjes së trupave serbe nga Kosova në një afat prej 7 ditësh. Në këtë takim delegacionin e NATO-s e kryesonte gjenerali Michael Jackson. Në ekipin e tij ishin gjeneralët e NATO-s Fritz Von Krof, Mauro Del Veçio, Bill Rollo, Adrian Freer dhe John Craddock. Delegacionin e qeverisë së Beogradit e kryesonte gjenerali Svetozar Marjanoviq, zëvendësshef i Shtatmadhorisë së Ushtrisë Jugosllave, dhe gjeneralët Bllagoje Kovaçeviq, Mlladen Karanoviq, Lubomir Draganjac, Branko Kërگا, Milan Gjakoviq, të gjithë nga Ministria e Mbrojtjes; gjeneralët Obrad Stefanoviq e Slllobodan Miletiq nga Ministria e Brendshme si dhe Nebojsa Vujoviq, ndihmësministër në RFJ.⁸⁴ Komandanti i forcave aleate të NATO-s për Evropën, Wesley Clark, në orën 15:36, suspendoi fushatën ajrore. Operacioni “Allied Force” përfundoi.⁸⁵

Në tërë Kosovën periudha para dhe gjatë bombardimeve të NATO-s ishte e shoqëruar me beteja të rrepta ndërmjet forcave ushtarake, policore e paramilitare serbe dhe forcave të UÇK-së. Janë të njohura beteja e Rrezallës (Rezallës), Likoshanit, Prekazit, Gllogjanit, Llapushnikut, Jezercit, Rahovecit, Kaçanollit, Llapashticës, Mazhikut (Mazhiqit), Ashlanit (Oshlanit), Zhegosit (Zhegocit), Koshares etj. Gjatë këtyre betejave ranë dëshmorë 2.132 luftëtarë, u plagosën 2.019 dhe pësuan lëndime të ndryshme trupore 48 luftëtarë të UÇK-së.⁸⁶ Sipas raporteve të

⁸³ Agjencia e lajmeve “Kosovapress”, 28 prill 1999.

⁸⁴ *Po aty*, 10 qershor 1999.

⁸⁵ W. K. Clark, *Të bësh luftë moderne...*, f. 417.

⁸⁶ Gjatë kohës sa kanë zgjatur bombardimet (24 mars deri më 9 qershor 1999) janë kryer edhe masakra të shumta të cilat kanë pasur qëllim pastrimin etnik të Kosovës. Masakrat më të tmerrshme, gjatë bombardimeve ishin: Masakra në fshatin Pemishtë (Padalishtë) të Burimit (Istogut), më 26 mars 1999, në Krushë të Madhe të Rahovecit

fillimviteve të pasluftës, janë vrarë 11.840 civilë, prej tyre 1.392 fëmijë deri në moshën 18-vjeçare, 296 fëmijë deri në moshën 5-vjeçare, 1.739 femra dhe 1.882 të moshuar mbi moshën 65-vjeçare. Janë dhunuar 20.400 femra shqiptare. Rreth 1.600 banorë janë ende të pagjetur.⁸⁷

Si përfundim, mund të thuhet se, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, si organizatë politike e ushtarake, pavarësisht rrethanave të krijimit, arriti që të organizohet dhe të krijojë strukturën që i mundësoi të bëhej partner politik e ushtarak i faktorit ndërkombëtar. Deri në mesin e vitit 1998, UÇK-ja arriti të bëhej një forcë ushtarake e uniformuar dhe me simbole unike. Kjo pati rëndësi të veçantë në përçimin e mesazhit se kauza e UÇK-së ishte kombëtare. Ky mesazh ishte i orientuar në tri rrafshë: rrafshi i parë ishte fitimi i përkrahjes së popullit brenda Kosovës pa dallime fetare; rrafshi i dytë ishte fitimi i përkrahjes së shqiptarëve në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Kosovë Lindore, si dhe shqiptarëve të diasporës; rrafshi i tretë ishte dërgimi i mesazhit të drejtë faktorit ndërkombëtar se lufta e Kosovës kishte karakter kombëtar e jo fetar, siç mendohej ta paraqiste Serbia.

Në aspektin e strukturës, UÇK evoluoi, nga një forcë guerile në fillimet e saj, në një forcë klasike ushtarake në përfundim të luftës. Disa nga momentet kyçe të procesit të ngritjes së UÇK-së ishin: krijimi i zonave operative, brigadave dhe batalioneve si dhe njësisive pranë

më 25, 26, 27 mars të vitit 1999, në fshatin Krushë e vogël më 26 mars, në Therandë (Suharekë) më 26 mars 1999, në Izbicë më 28 mars 1998, në Besianë (Podujevë), më 28 mars të viti 1999, Masakra e Burimit (Joviq) të Malishevës, më 31 mars 1999, në Kronarb (Lybeniq) të Pejës më 1 prill 1999, në Kralan të Gjakovës më 2 prill 1999, në Rezalle më 5 prill 1999, në Luginë (Lubizhdë) të Hasit, më 12-26 prill 1999, në Llashtisht (Llashticë) të Gjilanit më 13 prill 1999, në Makaj (Makoc), më 21 prill 1999, në Meje (Mejë) dhe Korenicë të Gjakovës më 27 prill 1999, në Martirat (Studime) të Vushtrisë, më 2 maj 1999, në Qyshk, më 14 maj 1999, në Paulan (Pavlan) dhe Siparant (Zahaq) të Pejës, më 14 maj 1999, në Drejan (Dubraves), më 19-24 maj 1999, në lagjen e trimave (lagjen Tusus) në Prizren, më 26 maj 1999. Sipas të dhënave të UNCHR (në fillim të qershorit 1999), vlerësohet se gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s (mars-qershor 1999), janë dëbuar më shumë se 850.000 shqiptarë nga shtëpitë e tyre. Të dhënat rreth të plagosurve, veteranëve dhe të lënduarve, janë bazuar në dosjet e UÇK-s, të cilat ruhen në arkivin e TMK-s. Këto të dhëna nuk përkrijnë me të dhënat të cilat janë sot në Komisionin qeveritar, të cilat janë kontestuar nga shoqatat e luftës dhe strukturat komanduese të UÇK-s.

⁸⁷ *Raporti i Fondit Ndërkombëtar të OKB-s për Popujt e Rrezikuar (FNUAP)*, Gjenevë, 25 maj 1999.

shtabeve në nëntor 1998; krijimi i Akademisë Ushtarake në dhjetor 1998; krijimi i batalioneve gardiste në prill 1999; themelimi i radios “Kosova e Lirë” në janar 1999; si dhe krijimi i trupës artistike “Hamez Jashari” në maj 1999. Është i rëndësishëm fakti se, edhe pse UÇK-ja evoluonte dhe ristrukturohej paralelisht me procesin e luftimeve kundër armikut, ajo arriti të ruajë komandën dhe kontrollin e plotë mbi të gjitha njësitë e saj gjatë gjithë kohës.

UÇK-ja, si një forcë e organizuar dhe e strukturuar mirë, u bë bartëse e proceseve politike e ushtarake në bisedimet ndërkombëtare për Kosovën. Krijimi i UÇK-së dhe veprimtaria e saj, i dha shtytje diplomacisë ndërkombëtare për të vendosur në rend të ditës çështjen e Kosovës.⁸⁸

UÇK me NATO-n, aleatin e saj në luftë kundër Serbisë, arriti çlirimin e Kosovës dhe hapi mundësinë e zgjidhjes përfundimisht të statusit politik e juridik të Kosovës. Si e tillë, lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XX, ngjarje e rëndësishme historike, jo vetëm për popullin shqiptar në Kosovë, por edhe me ndikim në marrëdhëniet ballkanike, evropiane dhe botërore.

S u m m a r y

THE KOSOVO LIBERATION ARMY (1994-1999)

From an historical perspective, the most important event of the 20th century for the Albanians of Kosovo and the Albanians in general, was certainly the liberation war of 1998-1999, led by the Kosovo Liberation Army.

The Kosovo Liberation Army as a political and military organization, despite the circumstances in which it was created, developed its structure from a guerrilla unit in its beginnings (1994) to a traditional military force (with its commanding and control structures similar to those of other military forces of the time) by the end of the war (1999).

⁸⁸ W. Petrisch & R. Pihler, *Rruga e gjatë në luftë ...*, f. 79-85, T. Judah, *Kosova luftë dhe hakmarrje...*, f. 154-160; B. Shala, “Lufta diplomatike për Kosovën. Dialog me ambasadorin Christopher Hill ...”.

The Kosovo Liberation Army through its political and military activity represented Kosovo in the international talks from 1998 to 1999. Its just and fair war made the international democracies consider the question of Kosovo as a priority of the time.

The fight of the Albanians led by the KLA was a historic triumph in the long struggle of the Kosovo people for freedom. It brought an end to the maltreatments, violations, imprisonments and killings, it brought an end to the genocide against the Albanians of Kosovo and to the presence of Serbian police and other military forces.

The victory of KLA was a triumph achieved as a result of many battles across Kosovo and moreover a result of the international diplomatic and military support. The war waged by the Kosovo Liberation Army finally opened the way for a solution to the political and juridical status of Kosovo and therefore in the last decade of the 20th century was a historic event not only for the Albanians of Kosovo, but also had an impact on the Balkan, European and global relations.

